

Buletin

tetor 2015 - botimi 01



**Bletaria
prodhimi i
mjaltit**

Buletin



Zt. Hysen Shabanaj
Menaxher i Përgjithshëm i LAB

Të nderuar lexues,

Jam krenar të prezantoj për herë të parë në emër të punëtorëve të LAB-it këtë buletin emocionues.

Përpjekjet e mëdha të njerëzve tanë e kanë bërë të mundur që LAB të ketë këto arritje, megjithatë, dëshiroj të shprehë falënderimet dhe mirënjohjet e mia për marrëdhëniet e shkëlqyeshme të punës me Sharrcem-in dhe të gjithë hisedarët e përfshirë ngushtë në mbështetjen dhe implementimin e objektivave të projektit të cilat synojnë të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të komunës së Hanit të Elezit përmes përdorimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore agro-pyjore në linjë me Titan Group - Strategjia për Përgjegjësinë Shoqërore Korporative (CSR).



Laboratori për Aktivitete të Biznesit
Rr. Adem Jashari p.n.
71510, Hani i Elezit
Kosovë
Tel: 00 381 290 385 500 lok. 1120
www.lab-ks.org



Sharrcem është themeluar më 1936 duke operuar me një furë vertikale me kapacitetin prodhues prej 4,415 tonelata në vit. Sharrcem është blerë nga TITAN Group në vitin 2010, si rrjedhojë e procesit të privatizimit në Kosovë. Është e vetmja fabrikë e çimentos në vend, e cila gjendet në kufirin jugor. Që nga ai vit Sharrcem ka qenë i angazhuar në përpilimin e një Strategjie të Qëndrueshme serioze duke adresuar me prioritet nevojat e komunitetit.

Një vit pas blerjes nga TITAN Group, Sharrcem ka përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme teknologjinë dhe teknikat e veta për prodhimin e materialeve të papërpunuara dhe të çimentos dhe ka filluar zbatimin e sistemit të menaxhimit me standard të lartë. Këto sisteme janë sot të vendosura, të cilat mbulojnë shëndetin dhe sigurinë, mjedisin, cilësinë dhe janë transparente përmes parimeve të veta të qeverisjes.

TITAN Group konsideron qëndrueshmërinë të jetë një nga çështjet më të rëndësishme në kohën tonë dhe e ka konfirmuar përkushtimin e vet duke nënshkruar me Global Compact në KB. Si rrjedhojë, TITAN Group ka ngulitur thellë përgjegjësinë shoqërore dhe praktikat e qëndrueshmërisë në funksionet e veta. Duke nxjerrë frymëzim nga trashëgimia CSR e TITAN Group, Sharrcem, punon me zell në implementimin e projekteve dhe proceseve të brendshme dhe të jashtme për të përmirësuar performancën e përgjegjësisë së korporatës dhe ndikimin në shoqëri. Në këtë aspekt, përpjekjet e kompanisë janë të drejtuara në drejtim të mbrojtjes së mjedisit, arsimimit, krijimit të kulturës së sigurisë dhe shoqërisë më të shëndoshë, dhe me më të rëndësi, krijimit të punësimit.

Në vitin 2013, Sharrcem prezantoi impenjimin e vet për të themeluar dhe të financojë plotësisht një fondacion të pavarur, (Laboratori për Aktivitete të Biznesit - LAB). Në linjë me strategjinë CSR të Titan Group, projekti LAB synon të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të komunës së Hanit të Elezit përmes shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve natyrore agro-pyjore. Pa



dyshim, papunësia është shqetësimi kryesor i komunitetit dhe një barrë e rëndë e cila minon rritjen. Plani të cilin LAB ekskluzivisht është angazhuar t'a implementojë përbëhet nga krijimi i kompanive të reja bujqësore për të shfrytëzuar resurset e përmendura më lart. Financon sigurimin e aseteve, mbështetë dhe këshillon fillestarët dhe monitoron dhe raporton performancat e tyre. Operon në bashkërendim të plotë me Komunën dhe me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Rezultati veçse ekziston: aktivitet të reja, punësim dhe të ardhura për qytetarët e Hanit të Elezit.

Ky është projekti më i madh i Përgjegjësisë Shoqërore të Korporatës i cili është iniciuar deri më sot në Kosovë, dhe Sharrceci si promotor i tij, ka kryer dhe vazhdon të drejtojë Forume të numërta të Angazhimit të Hisedarëve që nga nisja në mënyrë që të sigurohet transparencë dhe vleftësim shoqëror.

Kompanitë e reja të cilat janë formuar përmes programit i shërbejnë qëllimit primar, përmirësimit të kushteve për komunitetin. Ndonëse për disa kompani private objektivi kryesor është gjenerimi i fitimit, kjo mund të arrihet vetëm në afat të gjatë kur shoqëritë përparojnë dhe zhvillohen. Një program i fuqishëm CSR është mënyra për të krijuar dhe mbrojtur fitimin dhe qëndrueshmërinë me ndikime pozitive të shumëfishta edhe për kompanitë edhe për shoqërinë aty ku operojnë.

Në fillim, projekti i është paraqitur hisedarëve, duke ilustruar proceset e inicimit dhe implementimi të fillojë gjatë vitit të parë. Këto mbuluan 3 faza kyçe:

- **Faza A: Ngritja e vetëdijes dhe sigurimi i aftësive për punë.**
- **Faza B: Mbështetja e krijimit të bizneseve të reja.**
- **Faza C: Këshillimi për qëndrueshmërinë e bizneseve vendore.**

Projekti mbështetet nga një seri e standardit të lartë të Parimeve të Qeverisjes, e përpiluar me ndihmën e IFC të cilat janë adoptuar nga Bordi i Pavarur i Drejtorëve të LAB-it. Njësitë e para bujqësore janë themeluar në vitin 2014 dhe prodhimet dhe korrjet e para tashmë janë shitur në tregjet lokale dhe të vendit. Kjo i jep LAB-it motivacion për të lëvizur me zmadhimin e gamës së agro-aktiviteteve; grupi i dytë i fillestarëve është përcaktuar dhe ka filluar furnizimi me asete.

Jemi krenarë të tregojmë një paraqitje të shkurtër në faqet në vijim të kësaj përvoje të cilën Sharrcem-i është i përkushtuar ta ruajë për vitet në vijim.





NEW OPPORTUNITIES FOR AGRICULTURE

Investimet e para përfshijnë punët në fushat e listuara më poshtë sipas rajoneve. Këto janë fushat të cilat ne konsiderojmë të jenë jashtëzakonisht të rëndësishme për të përmirësuar situatën ekonomike në komunitetin e Hanit të Elezit dhe përtej.

Numri	Spektori	Rajoni
5	Serra	(Lagjja e Re, Rezhancë, Paldenicë, Lac, Puset e Nikes)
2	Mjedra	(Lac, Lac)
3	Dredhëza	(Secishte, Uji i Thartë – Puset e Nikes, Secishte).
5	Bletari	(Hani i Elezit, Lagjja e Re, Puset e Nikes, Lagjja e Re, Paldenice)
4	Kërpudha	(Hani i Elezit, Paldenicë, Dimce, Hani i Elezit)

LAB ka dy marrëveshje të nënshkruara, një me IADK në Vushtri dhe tjetra me AFS në Selanik për të siguruar ekspertizën e tyre, përvojën, aftësitë teknike sa i përket

trajnimin, mbështetjen teknike, shërbimet e konsulencës, vizitat studimore dhe asistencë tjera për studime/vlerësim dhe implementim të projekteve bujqësore të LAB-it.

Trajnimet e ofruara nga IADK në Han të Elezit

Spektori	Trajnimi/seanca	Numri i pjesëmarrësve
Serra	10	5
Mjedra	9	2
Dredhëza	8	3
Bletari	5	5
Kërpudha	2	4

Me ndihmën e IADK-së - Iniciativa për Zhvillimin Bujqësor së Kosovës - dhe AFS - Shkolla Bujqësore Amerikane e Selanikut, LAB ka përzgjedhur një grup të fermerëve që të përfitojnë nga trajnime të ndryshme / seanca / kurse dhe këshilla teknike në tema të ndryshme për secilin sektor, edhe për pjesët teorike edhe për pjesët praktike.

Programi i trajnimit dhe materiali i trajnimit është përgatitur për 34 tema të ndryshme për përgatitjen e tokës, mbjelljes, kultivimit, mbrojtjes, korrjes dhe shitjes së produkteve për të gjithë 19 pjesëmarrësit.

Kontraktuesi i Sharrcem-it, Baker Tilly Kosovo, ka ofruar të kontribuojë me shërbimet për konsulencë biznesi për pjesëmarrësit pa pagesë, trajnimit



të tyre rreth regjistrimit të biznesit dhe menaxhimit financiar, dhe ka propozuar trajnime të ardhshme dhe shërbime të konsulencës bazuar në nevojat e përfituesve.

DISA FOTOGRAFI NGA SEANCAT E TRAJNIMIT

Vizitat studimore

Pas kësaj faze janë organizuar vizita studimore në të dy institucionet, në IDAK për grupet e përzgjedhura dhe për një javë, pesë (5) ditë pune në AFS në Greqi.

Vizitat janë organizuar për të marrë ide praktike për kultivimin e produkteve të ndryshme për nevojat e tyre, dhe në njërën nga këto vizita pjesëmarrësit janë pajisur me certifikata për pjesëmarrje.



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
 INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS
 INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA





Ka pasur po ashtu vizita studimore të ndryshme të organizuara në këto dy institucione edhe nga anëtarët e Komitetit të CSR Sharrcem së bashku me Menaxherin e Përgjithshëm dhe stafin e projektit LAB. Këto vizita kanë qenë po ashtu përvoja jashtëzakonisht të dobishme të mësimt.

Gjatë turneut, përfaqësuesit e Sharrcem-it dhe LAB-it kanë pasur mundësinë të bashkëveprojnë me anëtarët e ekipit nga IADK dhe AFS dhe kanë shkëmbyer informacione rreth aktiviteteve të tyre. Për më tepër, përfaqësuesit e LAB-it kanë mësuar po ashtu iniciativat e fundit të këtyre dy institucioneve, IADK dhe AFS.



Partnerët tanë zhvillimorë

Këshilltar për Prokurim dhe Specifikacione

Vushtrri, Kosovo



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA

Këshilltar Shkencor



AMERICAN
FARM SCHOOL
Thessaloniki · Greece

Trajnime dhe Transferim i Njohurive



Center
for Agricultural
Entrepreneurship

AT THE AMERICAN FARM SCHOOL & PERROTIS COLLEGE

Selanik, Greqi

Arritjet deri më sot të sektorëve të mbështetur - material me fotografi



Kultivimi i frutave të vegjël, dredhëza



Kultivimi i frutave të vegjël, mjedra



Kultivimi i perimeve në serra



Bletaria, prodhimi i mjaltit



Kultivimi i kërpudhave



Pika e shitjes LAB



Që kur projekti LAB filloi të prodhojë rezultate pozitive, ne kemi pasur nevojë të fillojmë punën në realizimin e menjëhershëm të pikës së shitjes.

Në bashkëpunim me komunën, ne kemi arritur të gjejmë një vend ku mund të ndërtojmë një depo, për shitjen e produkteve të freskëta sezonale, përafërsisht 50 m². Lokacioni është afër rrugës kryesore.

Pika e shitjes është dizajnuar dhe mirëmbajtur duke përdorur resurset e Sharrcem-it, dhe është ndërtuar nga kontraktuesi i palës së tretë.

Qëllimi i kësaj pike të shitjes është të sigurohet qasje në treg për fermerë të përfshirë në program. Kjo lejon ata të ekspozojnë dhe të shesin produktet e tyre në një mjedis të kontrolluar.







Të dhënat për produktet dhe shitjet


SEKTORI	SASIA E PROD-HUAR (NË KG)	FUSHA E MBJELLË (NË M ²)	PRODHIMTARIA MESATARE PËR NJËSI	ÇMIMI PËR NJËSI	VLERA TOTALE E SHITJES (NË EURO)	ÇMIMET E SHITJES MESATARE PËR NJËSI
SERRA: DOMATE	37,081.00	2,000.00	18.54	0.33	12,236.73	6.12
SERRA: TRANGUJ	5,646.00	500.00	11.29	0.36	2,032.56	4.07
SERRA: SALLATË E GJELBËR	1,848.00	1,000.00	1.85	0.77	1,422.96	1.42
MJEDRA	955.20	4,000.00	0.24	1.70	1,623.84	0.41
DREDHËZA	1,206.00	6,000.00	0.20	1.92	2,315.52	0.39
BLETARI	148.00	50.00	2.96	9.97	1,475.56	29.51
KËRPUDHA	496.00	150.00	3.31	2.01	996.96	6.65
TOTALI	47,380.20	13,700.00	38.39	17.06	22,104.13	48.57

38.39 / 7 = 5.48

48.57 / 7 = 6.94



Numri total i fermerëve të rinjë #37 / Sipas sektorit



Rezultatet

Deri më sot:



- 19 ferma bujqësore të regjistruara në gjendje pune.
- Rregullimi i pyllit dhe instalimi për ngrohjen e një shkolle publike dhe 20 shtëpi në lokacionin e Gorancës në komunën e Hanit të Elezit.
- Pika e shitjes e ndërtuar për të mirat e korrura.

47.4 tonelata

Prodhimi

Sektori	Sasia e prodhuar (në kg)	Fusha e mbjellë (në m2)	Prodhimtari a mesatare për njësi	Çmimi për njësi
Serra: Domate	37,081.00	2,000.00	18.54	0.33
Serra: Tranguj	5,646.00	500.00	11.29	0.36
Serra: Sallatë e gjelbër	1,848.00	1,000.00	1.85	0.77
Mjedra	955.20	4,000.00	0.24	1.70
Dredhëza	1,206.00	6,000.00	0.20	1.92
Bletari	148.00	50.00	2.96	9.97
Kërpudha	496.00	150.00	3.31	2.01
Totali	47,380.20	13,700.00	38.39	17.06

Numri total i orëve





Aktivitetet paralele

Nën ombrellën e projektit të LAB, kemi iniciuar nënprojektin e quajtur aktivitetet paralele. Grupi në objektiv ka qenë rinia e komunitetit. Nënprojekti fokusohet në arsimim dhe kontribut shoqëror duke rritur vetëdijen për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit, shëndetit dhe sigurisë, mësimin të gjuhës dhe kompjuterit.

Programi organizohet në bashkëpunim me LAB, dhe përdorë objektet dhe pajisjet e tyre në bashkëpunim me burimet njerëzore të Sharrcem-it. Një MiM është nënshkruar ku theksohet fusha e bashkëpunimit në mes të tri palëve, (Sharrcem, LAB dhe Komunës, në veçanti Departamentit të Arsimit).

Rezultatet e pritura janë arsimiti i rritur dhe zhvillimi ekonomik i rajonit. Janë mbajtur seanca trajnime në tri subjekte: IT (Teknologji Informative), Mjedisit, Shëndeti dhe Siguria.

Secilit grup të studentëve i janë dhënë mësimet të rëndësishme në këto tri çështje me të cilat trajtojnë sfidat në fushën e tyre. Ata kanë shprehur mirënjohje të sinqertë që kanë pasur mundësinë të marrin pjesë në këtë program. Është krijuar një grup në Facebook për ta në mënyrë që të shtrojnë pyetje në të ardhmen dhe të vazhdojnë të kujdesen për ndjenjën e komunitetit.

Nxënësit nga Hani i Elezit mësojnë për pyjet dhe rëndësinë e tyre

Më 17 shtator 2015, Sharrcem brenda projektit "Laboratori për Aktivitetet e Biznesit", ka marrë iniciativë për të organizuar një vizitë të njësisë e menaxhimit "Uji i Bardhë" në fshatin Gorancë me nxënësit e shkollës së mesme "Dardania" në Han të Elezit.

Është me shumë rëndësi të ceket se këta studentë, të cilët shkuan në vizitë, ishin ata të cilët shprehën vullnetin e tyre për të marrë pjesë në trajnimin / ligjëratën e mjedisit, të ofruar nga stafi i mjedisit i Sharrcem-it, dhe organizuar nga LAB sipas projektit "Aktivitetet Paralele".

Ata janë certifikuar me certifikata për pjesëmarrje në të njëjtën ditë për trajnimin të cilin e kishin marrë më

herët. Qëllimi kryesor i vizitës ishte që nxënësit të njoftohen me aktivitetet e LAB-it, përmes të cilave synohet të kontribuohet në rritjen e njohurive të nxënësve për resurset pyjore në atë zonë, rëndësinë e tyre për mjedisin, shoqërinë dhe ekonominë në

përgjithësi.

Fillimisht nxënësit ishin informuar lidhur me rëndësinë e pyjeve në përgjithësi, pastaj ata kanë pasur mundësinë të mësojnë më shumë rreth secilit lloj të drurit që gjendet në



këtë pjesë si dhe aktiviteteve pyjore të LAB-it të cilat janë duke u zhvilluar në bashkëpunim me Agjencinë e Pyjeve të Kosovës dhe Drejtorinë Komunale të Bujqësisë, Pyltarisë dhe Zhvillimit Rural, me qëllimin e përmirësimit dhe menaxhimit të hapësirës pyjore prej 20 hektarëve, që është në pronësi publike.

Objektivi afatgjatë i projektit të LAB-it është që ky koncept i testuar duhet të vendoset dhe të aplikohet në një shkallë më të gjerë duke përmirësuar gjërat për menaxhimin e pyjeve dhe ofrimit të sasive të mjaftueshme të lëndëve të drurit nga pastrimi i pyjeve. Mbeturinat pas prerjeve të rregullta do të përdoren në përpunimin e ashklave



të cilat do të përdoren për ngrohje për objektet publike, respektivisht në shkollën fillore në fshatin Gorancë në Komunën e Hanit të Elezit.



Vizitë arsimore me fëmijët parashkollorë të Hanit të Elezit

Mëse 100 fëmijë parashkollorë nga Hani i Elezit janë argëtuar me aktivitete të shumta në ambient të hapur. Sharrcem-i në bashkëpunim me Bordin e Fëmijëve nga komuna e Hanit të Elezit, mori këtë iniciativë për të gjithë fëmijët parashkollorë të kësaj komune. Kjo iniciativë është organizuar për herë të dytë dhe është pranuar me kënaqësi nga fëmijët dhe prindërit.

Ecja filloi në orët e hershme të mëngjesit, ku para nisjes, Sharrcem shpërndau bluza dhe kapela. Po ashtu, Sharrcem u kujdes për sigurimin e

ushqimit dhe pijeve për të gjithë fëmijët. Duke marrë parasysh se vizita kishte karakter edukativ, fëmijët ishin të shoqëruar nga Drejtori i Përgjithshëm i LAB-it, z. Hysen Shabanaj, i cili mbajti një ligjëratë informuese gjatë tërë ecjes.

Në fillim, fëmijët vizituan një nga fermerët e LAB-it, përkatësisht një fermë dredhëzash ku u njoftuan nga afër me procesin e kultivimit të kësaj bime dhe për shumicën e fëmijëve ishte hera e parë që shihnin plantacione të dredhëzave dhe vazhdimisht bënë

pyetje drejtuar fermerit dhe shpesh fytyrat e tyre tregonin se u bënë përshtypje përgjigjja e fermerit.

Fëmijët vizituan natyrën e gjelbërt të Puset e Nikës në rajonin e Hanit të Elezit.

Përfaqësues nga Sharrcem-i, si dhe z. Hysen Shabanaj, informoi fëmijët për rëndësinë e mjedisit në jetët tona dhe u zotua se çdo herë do të mbështesin aktivitetet të cilat do të ofrojnë shumë dobi për komunitetin në përgjithësi.

Fillestarët 2014 dhe 2015...

Papunësia akoma mbetet një nga problemet më të mëdha për shumë banorë të Hanit të Elezit, në veçanti për fermerë në zonat rurale, prandaj angazhimi i LAB-it në këtë fushë vazhdon në vitin 2015 për të mbështetur sektorët potencial të agro-biznesit të

cilat do të lehtësojnë dhe gjenerojnë të ardhura dhe punësim të ri.

Duke parë rezultatet me grupin e parë të pjesëmarrësve të përzgjedhur për këtë program, LAB-i ka vazhduar me projektin duke lëvizur me grupin e

dytë, për të cilin janë përzgjedhur 16 fermerë, me përfshirjen e një sektori shtesë (prodhimet e qumështit), i cili nuk ka qenë në dispozicion për grupin e parë.

- **Prodhimet e qumështit**
- **Serrat: Sallata, domatja, trangulli**
- **Kosheret**
- **Dredhëzat, mjedrat**
- **Pylltaria - kujdesi ndaj pyjeve**




Numri total i NVM-ve të reja 37

Rritja e biznesit

Pronarët e bizneseve të reja do të jenë përgjegjës për menaxhim dhe zhvillim të duhur për bizneset e tyre, duke siguruar pajtueshmëri të plotë dhe standarde më të larta të prodhimit.



Nga korrja drejt te hisedarët: Të nderuar nga reagimet e tyre!




E nderuara Zonja Berisha,

Faleminderit shumë për këtë dhuratë të jashtëzakonshme. Ishte kënaqësi e injja e madhe të shijoj këto dredhëza të mrekullueshme.

Urime.

Ferid Agani
Minister i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor




E nderuara Besa,

Faleminderit shumë për këtë befasi të këndshme. Urime ekipit të Sharrcem! Me të vërtetë u ndjeva e nderuar të pranë kutinë e dredhëzave të freskëta dhe të shijshme. Do të dëshiroja të goja këto në tregun Greq dhe të jeni të sigurt se do të isha një nga klientët më besnik. Jamë me të vërtetë shumë të shijshme, të embla dhe të freskëta...

URIME prapë dhe zgjas përgjëzimet e mia me të mira që ky produkt të zë vendin e parë në botë.

Maria Katsandri
Menaxhere e lartë rajonale e Burimeve Njerëzore



E nderuara Zonja Murati-Berisha,

Faleminderit shumë që na dërguat dredhëzat nga rendimentet e para nga projekti i LAB. Jo vetëm që ishin të paketuara bukur, por ishin po ashtu shumë të shijshme. Besoj se kjo është dëshmi e madhe e një projekti të suksesshëm të mbështetjes së dhënë fermerëve vendor nga Sharrcem dhe Komuna e Hani të Elezit.

Ju dëshiroj të gjitha të mirat dhe vashtoni të punoni kështu në të ardhmen po ashtu.

Pershëndetje të përzemërta,
Mendi Krasniqi
Minister i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural





Laboratori për aktivitete të biznesit

Buletin